



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

Procesverbal 08/2025

I Mbajtur në takimin e VIII-të të rregullt të KK-së me datën 31.08.2025, në sallën e Kuvendit në ora 10⁰⁰ nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e VIII-të të rregullt të Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Propozim – Vendim për Miratimin e Draft Planit Ndërkomunal për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Rajonin e Gjilanit dhe Ferizajt, si dhe Draft Vlerësimin Strategjik Mjedisor (VSM) planeve Ndërkomunale për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave për Komunat e Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Novobërdës, Parteshit, Klllokotit, Ranillug, Ferizaj, Kaçanik, Shtime, Han i Elezit, Shtërpçë;
5. Propozim – Vendim për subvencionimin e Transportit Urban dhe Urbano – Periferik dhe
6. Propozim – Vendim për miratimin e anëtarësimit në “ACES EUROPE”
7. Pyetje dhe kërkesa,
8. Të ndryshme.

Kryesuesi pyeti nëse ka dikush diçka rreth rendit të ditës dhe fjalën e morri Amir Rexhepi i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që unë propozoj që pasi jemi pran fillimit të vitit shkollor është e nevojshme që si çdo shtator të kemi informatë për këtë fillim vit.

Pasi ska tjerë kush është për miratimin e rendit të ditës dhe kaloi me 37 vota për, 0 vota kundër dhe 0 abstenim.

Edhe pika shtesë për anëtarësim ne ACES EVROPE që ka ardhë nga kabineti qeveritar që është pika e 6-të e listuar, kush është për ta futur në rend të ditës edhe kjo pikë kaloi me 37 vota për, 0 vota kundër dhe 0 abstenim.

Amir sa i përket pikës tande, o mirë me lanë për seancën tjetër se drejtori so këtu dhe u pajtuan ta lenë për muajin tjetër.

Rreth procesverbalit a ka najkush diçka, fjalën e mori Ibrahim Hyseni, i cili pasi përshëndeti të pranishmit, theksoi që unë e kuptoj që nganjëherë në procesverbal ka mundësi me ik najsen, mirëpo megjithatë nëse një fjalë nuk shkruhet i humb kuptimi, ne kur diskutum për trafikun urban, ku shkrun që pasi i përshëndeti shkrun që trafiku urban nuk është zgjidhje, unë skam than kështu, mirëpo kam thanë që “Për momentin nuk është zgjidhje perfekte” dhe kërkoj që kjo të korrigjohet, faleminderit.

Pasi ska tjerë, kjo pikë kaloi me 37 vota për, 0 vota kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 4-të dhe ia kaloi fjalën Drejtorit Alberton Sahiti, i cili pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që para vetes kemi Draftin e menagjimit të mbeturinave ku përfshihet Regjioni i Ferizajt dhe Gjilanit, që rregullon përfundimisht një problem të madh këtë plan, e kanë punu shumë ekspert edhe në bashkëpunim me GIZ-in Gjerman, kanë bërë një punë të mirë dhe si të tillë ju ftoj ta përkrahni, ku deri në Vitin 2030 bëhet një zgjidhje edhe me këto dy qendra të grumbullimit, një në Ferizaj dhe një në Gjilan, dhe nëse keni pyetje urdhëroni.

Ibrahim Hyseni, pasi përshëndeti edhe njëherë të gjithë, realisht unë ju përgëzoj edhe GIZ-in edhe juve për këtë plan, unë këto shifra që i pash besoj që janë të sakta vetëm një e kam kontestuese ku shkruan që Rajoni i Ferizajt ndodhet në pjesën juglindore të Kosovës në kufi me Serbi dhe besoj që ky është një gabim, andaj kërkoj që të korrigjohet.

Pasi spati të tjerë për të diskutuar, kryesuesi e hodhi në votim dhe kjo pikë kaloi me 36 vota për, 0 vota kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën e 5-të dhe përsëri ia kaloi fjalën Drejtorit Alberton Sahiti, i cili theksoi që tani kemi një propozim të kompletuar për subvencionim të transportit dhe kemi ardhë në përfundim që duhet të subvencionojmë 0.60 cent për km, për transportin urban dhe 0.40 për atë urbano periferik dhe e kemi bërë një plotësim të kategoritë që i kemi futur ndër të tjera edhe familjet me asistencë sociale.

Verona Isaaku pasi përshëndeti të pranishmit, po më doket që për transportin publik është tu marr pak si hov i madh për mu subvencionu edhe nuk është tu skjaru qysh duhet në transport urban kur subvencionohen qeto dy kompani a kanë mu subvencionu veç qeto dy kompani, a kanë mu subvencionu edhe kompani tjera, d.m.th. qaj komision ka mu formu, ndërsa t'i i ki veç dy kompani që i ke angazhu për transport urban, ju keni than qe transporti urban trafiku i i banë 8 linja në ditë, ndërsa ai i banë veç 6, na mënojmë që kanë me ndodhë keqpërdorime të krejt qetyne fondeve që keni mi dhanë.

Hatixhe Bungu Qerimi pasi përshëndeti të gjithë theksoi që sot po flasim për transport dhe duhet ta përkrahim, mirëpo ky subvencion të zbatohet për periudhën 5 vjeçare, me mundësi vazhdimi dhe unë propozoj që të jetë 3 vjeçare me mundësi vazhdimi, për arsye se këto kategori që i keni parapa për mi subvencionu, janë mirë të menduara, mirëpo kërkohet nga operatori, pasi këta autobus nuk i plotësoj kriteret për mi bart udhëtarët për pesona me nevoja të veçanta dhe kërkoj që të plotësohet ky kriter, pasi s'kan qasje, kërkoj që linjat të shtohen të bëhen çdo 15 minuta, këto janë propozimet e mijë për ndryshe jam pro.

Amir Rexhepi pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që edhe herën e kalume me ba studimin drejtori, drejtor çka nëse me këtë propozim që ne e votojm, nuk ta pranojnë operatorët, pasi tash fillojnë shkollat, ndërsa nxanëst kanë me pagu 2 her, pasi ka procedur, deri sa ky vendim të kthehet nga ministria, pra d.m.th. që veç jau keni vështirësu gjendjen, po pres përgjigje që tani me repliku.

Zekir Bytyqi, falënderoj kryesuesin, përshëndeti të gjithë, vërejtjet e mijë kanë qenë që subvencionimi të mos bëhet për km, që km të gjindet përmes (nuk dëgjohet) është transparente, andaj unë jam për këtë subvencionim.

Arian Imeri pasi përshëndeti të gjithë të nderuar ne para vetës e kemi subvencionimin që e patëm në seancën e kaluar, ankesa të cilat po besoj që janë rregullu, pastaj edhe në KPF pat kërkesa për plotësim dhe po e shohë që edhe ato janë inkorporua, siç duhet të gjithë e kemi materialet e njëjta dhe s'besoj që duhet të ketë anëtar kundër këtyre kategorive po ashtu ne pasi kemi rregullu stacionin edhe transportit i ka ardhë rendi edhe subvencionimit, s'është diçka që pe bajmë për herë të parë, pasi kjo bahet në shumë vende të botës dhe ju ftoj që ta përkrahni.

Ibrahim Hyseni dola edhe njëherë, unë e lexova këtë propozim dhe më pëlqej, ndoshta afati 5 vjet është pak i gjatë, po duhet t'i kemi parasysh kushtet edhe të ndërmarrjeve, pasi për kohë të shkurt ndoshta s'do të kenë mundësi të investojnë, ndërsa për 5 vite besoj që edhe është më mirë, unë drejtor e pash edhe personat të dala nga lufta, andaj aty besoj që përfshihen të gjithë, pasi ne kemi dal krejt nga lufta dhe besoj që kjo duhet të specifikohet, faleminderit.

Alberton Sahiti theksoi që do të subvencionohen të gjitha kompanitë që kanë linja, si në urbano periferik edhe urban, po ashtu edhe çmimi është i përfshirë si në propozim.

Amir Rexhepi i përmende kompanitë, drejtor unë s'besoj që e kanë mirëprit, pasi me këtë s'besoj që kanë me ja dalë, e ajo çka o ma me rëndësi drejtor, a i ke informu ata që nuk ki buxhet, mas një muaje kanë me ta lanë, pasi s'ki buxhet, pasi i keni detyru një muaj pa pagës, asni cent s'jau keni qit.

Kryesuesi pyeti të pranishmit a jeni për 2 vjet, a për 5 dhe drejtori theksoi që sipas të gjitha parametrave që kemi ba Vendimi për subvencionim të jetë 5 vite dhe kaloi me 28 vota për, 0 vota kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi e lexoi pikën shtesë për anëtarësim në ACES EUROPE, ku kryesuesi theksoi që është një propozim që vjen nga kabineti, a ka najkush për të diskutu dhe pasi spati kjo pikë u votua dhe kaloi me 30 vota për, 0 vota kundër dhe 0 abstenim.

Kryesuesi pyeti a ka të interesuar për pyetje dhe kërkesa pasi s'pati në të ndryshme s'pati kryesuesi e shpalli të mbyllur mbledhjen.

Procesmbajtësi


Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës


Xhavit Zariqi

